



## PROCESVERBAL

### TAKIMI PUBLIK ME QYTETAR

Mbajtur më 24.06.2022 ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës  
Pjesëmarrës: 43 qytetarë

#### Ferit Idrizi- Kryetari i Komunës – në fjalën e tij hyrëse shpalosi projektet për gjashtë mujorin e vitit 2022

I njoftoj të pranishmit për punët që janë kryer gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2022, projektet që janë duke u realizuar si dhe ato që do të realizohen deri në fund të vitit. Informoi gjithashtu edhe për vonesat në fillimin e realizimit të disa projekteve për shkak të alokimit me vonesë të buxhetit të Komunës nga ana e Ministrisë së Financave.

Lidhur me projektet e vitit të ardhshëm kërkoi nga të pranishmit që të jenë pjesëmarrës aktiv në dëgjime buxhetore që do të organizohen në muajin korrik 2022 në të cilat do të ofrohet mundësia e paraqitjes së kërkesave dhe nevojave për projektet prioritare për komunitetin në vendbanimet e tyre. Ai njoftoj se edhe ditën e shtunë do të punohet për bashkatdhetarët të ardhurë nga diaspora.

Në fjalën e tij përmbyllëse propozoi që të hapet diskutimi dhe zhvillohet debat me qytetar duke i dhënë komentet e tyre për punën e Kryetarit – qeveris komunale.

#### Diskutimet nga qytetarët

**Ismajl Haziri – Vushtrri**, kam disa kërkesa : -të formohen këshillat e lagjeve në qytet, - të shpërndahen kontejner për banoret e lagjes Urbane Kalaja, - në rrugën “2 Maji” ka shtylla elektrike që janë shqetësuese për banoret sepse është rrezik të bijnë, - kërkesë e banorëve janë edhe Semaforat në rrugën Magjistrale. Ai pyet pse ka rritje të tatimit në pronë?

-Gypat e ujit janë dëmtuar dhe kompania e ujësjellësit nuk vjen me rregullu. -Ndërsa për Harta zonale banoret nuk janë konsultu, edhe trafo e rrymës nga viti 2005 ka nevojë të ndërrohet.

**Kryetari** – Sa i përket gypave të ujësjellësit, shtyllave elektrike si dhe semaforëve nuk është përgjegjësi e Komunës por do të mundohem të ju ndihmojë, do të thërras në KEDS, ujësjellës si dhe Ministrinë për shqetësimin tuaj.

**Zekri Muzaqi, nga fsh.Brusnik** – Kemi kërkesë nga fshatrat e Ortakollit për rregullimin e rrugës prej Lumit Silnica deiri në Bukosh sepse është dëmtuar shumë. – Pastaj rruga te Edona Market të bëhet rrugë dy kahje për shkak se bëhen kolona të gjata. – Pagesën e 80euro-ve për ujësjellës që e kemi bërë a na kthehet tash me vendimin tënd të ri?

**Kryetari** – Ky segmet i rrugës deri në Bukosh është në kompetencë të Ministrisë ndërsa për rrugën te Edona-Market - deri te rrethi do të bëhet një projekt. Ndërsa sa i përket vendimit për pagesë të kyçjes në ujësjellës vendimi është vetëm prej datës kur e kam marrë vendimin.

**Ridvan Përçuku, fsh. Ceceli** – Problem i fshatit Ceceli është nga Gurthyesi i cili e dëmton rrugën dhe kanali ka ndërruar kahje si dhe kur ka reshje dëmtohen arat, ndërsa rruga që është te shkolla është e pa kalueshme nga këta gurë. Fshati Ceceli ka nevojë të përfshihet edhe 30% me ndriçim publik si dhe të vazhdohet me kanalizim që është mbetur te ura. Është renovuar shkolla dhe mbeturinat e forta kanë mbetur në oborr të shkollës që është rrezik për nxënësit sepse aty ka gjarpërinjtë. Kërkesë e jona është të vendosen edhe ulëse dhe drunjë dekorativ në oborre të shkollës.

**Kryetari** – Në atë rrugë kemi dërguar bagerin dhe është duke u punuar, ndërsa për shkollën Drejtoria e Arsimit do të merret me këtë problem, edhe për kanalizim do të punojmë kurse ndriçimi do të mundohemi të gjejmë ndonjë mundësi me kosto më të ulët.

**Hajrullah Bajrami fsh. Liqej** – Shqetësuese për banorët është kanalizimi si dhe ka lagje që kanë nevojë për shtrurje të rrugëve me zhavorr.

**Kryetari** – Do ti kemi parasysh kërkesat e juaja.

**Fazli Merovci fsh. Samadrexhë** – të bëhet rehabilitimi i lumit që kalon nëpër fshat sepse na i dëmton arat si dhe kanalizimi ka mbetur pa përfunduar në arën time që më shkakton dëme dhe unë s'mundëm me punuar atë arë.

**Kryetari** – Do ti kemi parasysh kërkesat e juaja Drejtoria për Shërbime Publike do të merret me këto probleme.

**Agim Hashimi, fsh. Banjskë** – Nga ndërtimi i Autostradës na u ka pamundësua të hyjmë në arat tona për të punuar, ju lutëm të na bëni zgjidhje.

**Kryetari** - Drejtoria për Shërbime Publike do të merret me kërkesën tuaj.

**Ahmet Zabërgja fsh. Ropicë** – Fshati jonë ka mungesë të ujit si dhe kemi nevojë për urë e cila është e ulët dhe kur ka vërshime bëhet e pa kalueshme, pastaj rruga “Selmon Zabërgja” është e pa kalueshme.

**Kryetari** – Jemi duke punuar intenzivisht në përmirësimin e rrugëve.

**Ahmet Seferi, fsh. Shalë** – Në fshatin Shalë është rryma e dobët si dhe ka mungesë të shtyllave elektrike, në këtë fshat kemi nevojë për kanalizim si dhe rrugët janë dëmtuar nga shtrirja e gypave të ujësjellësit dhe nuk janë rregulluar. Projekti me erë në Qyqavicë a është duke u punuar? A ka projekt për rrugën e vjetër nga varret deri në Novolan që e lehtëson qarkullimin e qytetarëve?

**Kryetari** – Për shtyllat elektrike është KEDS, ndërsa për rrugë të dëmtuar do ti riparon Komuna.

**Murat Bunjaku – fsh. Samadrexhë** - Të zgjidhen përfaqësuesit e fshatrave, në Drejtorinë e Bujqësisë kur është koha e ndarjeve të mjeteve bujqësore, ka padrejtësi edhe jepen pajisje pa kritere dhe për njerëz që si përdorin.

**Kryetari** – Për çdo parregullsi të më lajmojnë bujqit dhe do të merren masa nëse ka kësi keqpërdorime.

**Flurim Gerguri – fsh. Studime e Epërme** – Studimja përballet me mungesë të ujit, gjendja e shkollës është jo e mirë, pjesa e brendshme duhet të rinovohet, ska kompjuterë, ska hapësira për rekreacion, rrjeti i rrymës elektrike është i pa mirëmbajtur ka 70 vite. Sektori i rinisë sa do të përkrahet?

**Kryetari** – Do të ketë thirrje për Star Up. Kemi projekte për Studime. Ndërsa do të bisedojmë me KEDS për rrym dhe shtylla. Sa i përket ujit do të fillohet me projekt për ndërtimin e një bazenti në Skoqne që përfshin të gjitha fshatrat e asaj ane.

**Nexhmedin Merovci fsh. Dobërlluk** – Në fshatin Dobërlluk ka deponim të mbeturinave nga ndërtimet e forta si dhe lumi është i pa pastruar nga mbeturinat, mungojnë shenjat në rrugë dhe emri i fshatit nga ku deri ku është fshati nuk dihet.

**Kryetari** – do të vendosen emrat e fshatrave si dhe me të tjerat do të merret Drejtoria për Shërbime Publike.

**Hamdi Shyti- fsh. Oshlan** - kemi kërkesë për vazhdimin e rrugës që lidh pjesën me Mitrovicë, si dhe në fshatin Oshlan ka shtëpi pa numra identifikues.

**Kryetari** – Për segmentin që lidh Vushtrinë me Mitrovicën do të bëjë kërkesë në Ministri.

**Shefqet Hajdari – fsh. Mavriq** – rruga “Xhem Barja” të kapet me Pestovë, kemi nevojë edhe për kanalizim në lagjen Klinaku. Kemi telashe edhe me një banor që hedh plehra në pronë të shtetit e që është pran xhamisë që nuk mund të kalosh andej nga era që kundërmon. Të bëhet subvencionimi i të rinjve për pjesëmarrje në turnire të boksit.

**Kryetari** – Me problemet e rrugëve dhe kanalizimet do të merret Drejtoria e Shërbimeve Publike, për sa i përket të rinjve për sport, të bëni kërkesë dhe do të ju ndihmojmë me mjete financiare.

**Arsim Sinani – fsh. Zagori** – kam nevojë për rrugë 10 km që e kemi pa asfalt si dhe telat e rrymës janë shumë ultë sa që s’mund punosh as arat nga rreziku i rrymës. Nga kushtet e këqija nuk mund të merrem as me delet as nuk mundemi të jetojmë në atë vend.

**Kryetari** – Do të ndihmohesh për stallë , për rrugë për qumësht, dhe për kok delesh që ti të mundësh të jetosh atje e mos të largohesh nga ai vend.

**Qendrim Ademi fsh. Pestovë** – shqetësim i fshatit Pestovë është mbyllja e gypave të ujitjes, patatet po na dëmtohen si dhe dëmtimi i bankinës nga mbeturinat që hedhen andej.

**Kryetari** – Sistemin e ujitjes e menaxhon ndërmarrja Ibër – Lepenc dhe ju duhet të kërkonti zgjidhje nga kjo ndërmarrje.  
Për dëmtimin e bankinave të na ndihmojnë shoqata e Peshkatarëve në lajmërimin e personave të cilët i dëmtojnë.

**Mentor Gërgjaliu – fsh.Studime e Poshtme** – a ka planifikim Komuna për kanalizim dhe semaforë në rrugën magjistrale.

**Kryetari** – do të punohet për kanalizim e për semaforë është përgjegjësi e Ministrisë.

**Eset Prekazi fsh. Stanofc i Poshtëm** – rrugët e pa asfaltuara, shtyllat elektrike janë disa nga kërkesat e këtij fshati.

**Rrustem Rashica fsh. Studime** – kur do të shtrohet rruga 200m në fshat.

**Faik Mehulli – fsh. Shtitaricë** – rruga në fshat ka 300m që është e shtruar dhe çdo herë kur ka vërshime bartet zhavorri dhe dëmtohet, si dhe ka nevojë për kanalizim. A ka mundësi që të bëhet bartja e nxënësve me kombi për në shkollë. Rruga deri te shkolla është 1.5km.

**Kryetari** – rrugën do ta rregullojmë ndërsa për nxënës të bëni kërkesë ne Drejtorin e Arsimit.

**Ymer Haradinaj- fsh. Stanoc i Epërm** – Kemi kërkesa të shumta për infrastrukturë rrugore, kërkesë tjetër është gypi i dëmtuar i ujësjellësit në lagjen “Cakaj” pastaj kanali i mbyllur në Rr “Ferat Haxhaj” si dhe të konsultohen kryetarët e këshillave të fshatrave për ndihma që shpërndahen për festën e Bajramit.

**Kryetari** – Sa i përket dëmtimit të gypit do të merret Drejtoria për Shërbime Publike si dhe Drejtoria për Mbrojtje e Shpëtimit për kanalin e mbyllur.

**Takimi publik me qytetar përfundoi në 12:20**

Procesmbajtësi e

Besarta Muzaqi Feka



Kryetari i Komunës

Ferit Idrizi

